



Teatri Kombëtar i Kosovës fitoi çmimin “Grand Prix” në Rumani

Shfaqja “Eshtrat që vijnë vonë” i solli Teatrit Kombëtar të Kosovës çmimin e parë të rëndësishëm ndërkombëtar. Kjo shfaqje rrëmbeu vendin e parë në Festivalin Ndërkombëtar të Bukureshtit të Rumanisë, ku rrjedhimisht u shpërblye edhe me çmimin “Grand Prix”.

Çmimi shfaqjes “Eshtrat që vijnë vonë” iu dha për fuqinë, drejtpërdrejtshmërinë, thjeshtësinë dhe aftësinë interpretuese, regjisoriale dhe skenike.

Ky është çmimi i parë i madh që Teatri Kombëtar e merr në një festival ndërkombëtar pas luftës, shkruan zeri.info.

Lajmin e bën të ditur drejtuesit e Teatrit Kombëtar të Kosovës, përmes një konference për media, ku ndër të tjera drejtori gjeneral i këtij teatri, Agim Sopi, tha se depërtimi i TKK-së në skenën ndërkombëtare ishte një synim i këtij menaxhmenti dhe se ata mund të mburrën që me shfaqjen “Eshtrat që vijnë vonë” sollën nga Rumania një çmim të rëndësishëm.

“Duam të bëjmë një rezyme të shkurtër të kësaj punë pesë-gjashtë mujore prej kur kemi filluar. Intencat tona kanë qenë që teatrit të ia kthejmë seriozitetin dhe profesionalizmin, të inskenojmë tekste që i kanë hije dhe i rrinë mirë teatrit, të profilizojmë trupën tonë dhe që teatrit ta hapim ndaj botës që të japim dhe të marrim nga rrjedhat kulturore dhe estetike të Evropës dhe më gjerë. Në kuadër të këtyre intencave ne tashmë kemi realizuar disa projekte që mund të themi se ia kanë kthyer seriozitetin teatrit, filluar nga shfaqja ‘Grafitet’, pastaj ‘Eshtrat që vijnë vonë’, ‘Tregtari i Venedikut për të vazhduar në dhjetor me shfaqjen ‘Pasardhësi’, sipas tekstit të Ismail Kadaresë. Pas disa prezantimeve në rajon, Teatri Kombëtar ka qenë pjesë e një festivali të madh, siç është ai i Bukureshtit, të cilin e organizon NETA, një rrjet që tubon 67 teatro evropiane dhe pretendon të mbështes shprehjen e re teatrore. Ne mund të mburremi se përveç pjesëmarrjes, nga Rumania kemi sjellë edhe çmimin e parë ‘Grand Prix’ për shfaqjen ‘Eshtrat që vijnë vonë’. Shpresoj që ky të jetë vetëm fillimi”, tha ndër të tjera Sopi.

Në anën tjetër, drejtori i artistik i TKK-së, Agon Myftari, tregoi se si shkoi mbyllja e festivalit në Rumani ku ata në sallën e mbushur plotë morën çmimin e ndarë nga juria profesionale.

“Pritja një festival ka qenë e jashtëzakonshme dhe reagimet e publikut gjithashtu, duke filluar që nga juria. Ne jemi të kënaqur dhe na vjen shumë mirë që morëm pjesë në një festival të tillë, por çmimi që morën ma bën krenar dhe na motivon”, theksoi Myftari.

Shfaqja me tekst të Teki Dërvishit, titulluar “Eshtrat që vijnë vonë” është përgatitur nga regjisori maqedonas, Martin Kocovski. Me rolet e tyre në këtë shfaqje paraqiten aktorët Astrit Kabashi, Bajrush Mjaku, Adrian Morina, Shkelzen Veseli, Lumnie Sopi, Arta Selimi, Albulena Kryeziu, Armend Baloku dhe Bujar Ahmeti. Lexoni më shumë në numrin e nesërm të gazetës Zëri.